

Libri (romani):

waldgut.ch

Waldgut
W

Arif Demolli

Na ishte një fshat në Kosovë

Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie

Përkthimi i parë gjermanisht nga Basil Schader, shtëpia botuese *Waldgut Verlag*, Frauenfeld 2011, në serinë *Kujtesa e popujve*, broshurë, 400 faqe, ISBN 978-3-03740-262-7

«Unë nuk mund të heq dorë nga fshati im, nuk mund ta lë të vdesë, të tretet edhe nga kujtesa, të zhduket përgjithmonë. Ndaj i dhashë shpirt: Që ai të jetojë – të jetojë të paktën në mbretërinë e amshueshme të përallës.»

Arif Demolli

Në botën e mbyllur të fshatit Murrizajë në lindjen e Kosovës, në vitet 1950, jeta e një fëmije ishte plot me mrekullira dhe tmerre. Në mënyrë të barabartë, të vdekurit jetonin midis të gjallëve, dhe kudo ndihej besimi të shtrigat dhe vampiret.

Sot, për jetën e dikurshme në Murrizajë dëshmojnë vetëm disa rrënoja të humbura dhe varret e përmbysura në varrezën e dervishëve – gati të mbytura nga bari i egër.

Me tregimet poetike nga fëmijëria e tij, plot me humor dhe me ngrohtësi, Arif Demolli na jep pamjen e një bote të humbur – të huaj, magjepsëse, por nganjëherë edhe shumë të afër.



Arif Demolli (djathtas) me përkthyesin e tij zviceran